



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1019 Prot.
11

Tiranë, më 26. 4 .2021

VENDIM
Nr. 16, datë 26. 04 2021

“Për miratimin paraprak të tarifave të aplikimit dhe studimit për programet e studimeve të doktoratës në Universitetin e Tiranës”

Bazuar në nenin 3, pika 3/ç; nenin 38, pikat 1 dhe 3; nenin 79, pika 5; nenin 98, pika 2/c, të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”; në Seksionin IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.2.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; në nenin 7, pika 3/ç; neni 31, gërma u; nenet 98 dhe 99, të Statutit të Universitetit të Tiranës si dhe në propozimin e Administratorit të UT-së, të mbështetur në propozimet e njëjësive kryesore, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 26.04.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht tarifën e aplikimit për programet e studimeve të doktoratës në vlerën monetare prej 5.000 lekë për program.
2. Të miratojë paraprakisht tarifën e studimit për programet e studimeve të doktoratës në vlerën monetare prej 450.000 lekë për program.
3. Kostot e tjera mbi këtë tarifë financohen nga subjekte të tjera, ose vetëfinancohen nga kandidati për doktorant, sipas marrëveshjes që lidhet me UT-në.
4. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit Tiranës.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha
